

V E N D I M
Nr. 323, datë 4.7.2002

**PËR KALIMIN E KORPUSIT TREKATËSH TË "ALIMPEKS" SH.A.-SË SHKOZET,
DURRËS, NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË PUNËS DHE ÇËSHTJEVE
SOCIALE**

(Ndryshuar me VKM nr. 294, datë 8.5.2003)

(i përditësuar)

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 dhe 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" dhe të nenit 2 të ligjit 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Regjistrimin e pasurisë së paluajtshme "Magazinat e korpusit trekatësh, me pamje nga deti, me sipërfaqe ndërtimi 1182,9 m², që administrohet nga "Alimpeks" sh.a. në pronësi të Republikës së Shqipërisë dhe kalimin në administrim të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale", si organ shtetëror përgjegjës për administrimin e pasurisë së paluajtshme të mësipërme.

2. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale t'i japë Shoqatës së Invalidëve të Punës të Shqipërisë, për nevoja të saj, pasurinë e paluajtshme të treguar në pikën 1 të këtij vendimi, në huapërdorje, pa kundërshtpërblim dhe të nënshkruajë e ndjekë zbatimin e kontratës përkatëse të huapërdorjes.

3. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe "Alimpeks", sh.a.-ja, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko